



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 01/9 Prot.

Tiranë, më 25.02.2022

V E N D I M

Nr. 05/1, datë, 25.02.2022

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku, dëgjoji pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Mbi kërkesën e Drejtuesit Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, z.Kreshnik Ajazi, nr.11800 datë 30.12.2021, "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, Olsi Marku", protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numer protokollit 01, datë 06.01.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", ka nxjerrë Urdhërin nr.05, datë 28.01.2022 "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, Olsi Marku, për kryerjen e shkeljeve disiplinore në formën e:

- "zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të policisë gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj.", dhe
- " mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues, që ka për detyrë të informojë kryesisht.",

parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", **neni 33, pika 3, gërmat "a", dhe "ç" të këtij ligji.**

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan, Kreshnik Ajazi dhe dokumentat që e shoqërojnë atë, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", lidhur me afatet e hetimit, të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku ,

gjatë kryerjes së veprimeve hetimore në kuadër të procedimit penal nr.2107, regjistruar në datën 21.10.2019, për veprat penale, “Fallsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, dhe “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga nenet 190 dhe 248 të Kodit Penal.

Gjatë zhvillimit të procedurave disiplinore për këtë rast, në Komisionin e Policisë Gjyqësore u paraqit një propozim tjetër nga Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan, për procedimin disiplinor ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku lidhur me zvaritjet e pajustificuara të lejuara prej tij gjatë kryerjes së veprimeve hetimore për procedimin penal nr. 2084, regjistruar në datën 16.10.2019.

Në rrethana të tilla, Komisioni i Policisë Gjyqësore, mbështetur në nenin 32 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” dhe nenin 5, pika 5 të Rregullores nr.10, datë 21.04.2020 “Për procedimin disiplinor”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, në mbledhjen e datës 16.02.2022, bëri shtimin e objektit të procedimit disiplinor ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku, me shkeljet e parashtruar në propozimin e drejtuesit të Prokurorisë Elbasan, të kryera në kuadër të hetimit të procedimit penal, nr. 2084, i vitit 2019.

Në propozimet e Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan parashtrohen shkeljet e përsëritura të afateve hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore Olsi Marku, moskryerja e veprimeve hetimore ose kryerja e tyre përtej çdo afati të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Penale dhe atyre të caktuara nga prokurori, si dhe sjelljet dhe qëndrimet mospërfillëse të tij ndaj kërkesave të vazhdueshme verbale dhe shkresave zyrtare të prokurorit, nëpërmjet të cilave kërkohej kthimi i dy procedimeve penale, deleguar këtij oficeri për kryerjen e veprimeve hetimore sipas afateve të caktuara në urdhërat përkatës të delegimit.

Nga aktet dhe provat që u administruan gjatë seances dëgjimore për procedimin disiplinor, u provua se:

2.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në datën 21.10.2019 ka regjistruar procedimin penal **Nr. 2107** për veprat penale “Fallsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, dhe “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga nenet 190 dhe 248 të Kodit Penal.

Procedimi penal është ndjekur fillimisht nga prokurorja Erida Kokonozi dhe më pas nga prokurorja Edlira Bako.

Me kryerjen e veprimeve hetimore për këtë procedim është ngarkuar oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku.

Në datën 06.11.2019, prokurorja e çështjes ka nxjerë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore dhe delegimin e kompetencave, në të cilin janë pasqyruar veprimet hetimore që duhet të kryeshin nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Olsi Marku. Në urdhër është lënë si afat maksimal për kryerjen e veprimeve hetimore, data 22.12.2019

Rezulton se nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku janë kryer vetëm dy veprime hetimore, janë dërguar dy shkresa, në datën 04.02.2020, një drejtuar ASHK dhe një Gjykatës së Rrethit Elbasan, edhe këto jashtë afatit të caktuar nga prokurori.

Në datën 08.06.2021, prokurorja e çështjes Erida Kokonozi, ka mbajtur akt konstatimi mbi veprimet hetimore të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku, në të cilin ka pasqyruar moskryerjen e veprimeve hetimore brenda afatit të caktuar dhe ka caktuar afatin e ri për kryerjen e tyre dhe përfundimin e hetimeve, datën 31.06.2021.

Më pas, çështja është marrë në ndjekje nga prokurorja Edlira Bako, e cila në datën 29.09.2021, nëpërmjet email – it zyrtar i ka kërkuar oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku informacion për ecurinë e procedimit penal. Nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku nuk i është kthyer përgjigje prokurores Edlira Bako.

Po me Email – in zyrtar, datë 10.12.2021 nga prokurorja Edlira Bako, i është kërkuar oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku që brenda dates 06.12.2021 të përcillte në prokurori aktet e procedimit penal së bashku me relacionin përfundimtar për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Përsëri nga oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku nuk ka patur asnjë reagim.

Në datën 10.12.2021 i është kërkuar me shkresë oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku të dërgojë në prokurori aktet e procedimit penal dhe relacionin shoqërues, duke nënvizuar se ka kaluar çdo afat i arsyeshëm ligjor dhe se mosjellja e tyre përbënte shkak për përgjegjësi disiplinore.

Përfundimisht aktet e procedimit penal janë dërguar në prokurori me shkresën e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, datë 17.12.2021.

Nga akatet e procedimit penal, rezulton se procedimi penal është mbajtur në hetim nga oficeri policis gjyqësore Olsi Marku **për mbi 2 vjet**, pa u kryer veprime hetimore dhe është dorëzuar në prokurori në datën 17.12.2021. Nga studimi i fashikullit të hetimit rezulton se për dy vjet nga oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku janë kryer vetëm dy veprime hetimore, dy shkresa dërguar institucioneve te tjera. Prej tij janë lejuar zvarritje të theksuara dhe të pajustificuara nga pikpamja ligjore.

Gjithashtu, u provua se oficeri i policisë gjyqësore Olsi Marku nuk ka informuar prokurorin e çështjes për ecurinë e hetimeve, për këtë procedim penal, megjithë kërkesat e vazhdueshme të prokurorit. Dosja është dorëzuar në prokurori në datën 17.12.2021, tej çdo afati hetimor të arsyeshëm dhe atij te caktuar nga prokuroi.

2.2 Në datën 16.10.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka regjistruar procedimin penal **nr.2084**, për veprën penale “Fallsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, dhe “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga nenet 190 dhe 248 të Kodit Penal.

Fillimisht procedimi penal eshte ndjekur nga prokurorja Erida Kokonozi.

Pas regjisitrimit të procedimit penal, në datën 17.10.2019 prokurori i çshtjes ka përpiluar urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, të cilin, së bashku me fashikulin e procedimit penal, ja ka dërguar oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku.

Në funksion të hetimit të procedimit penal, prokurori ka caktuar kryerjen e disa veprimeve hetimore duke caktuar si afat datën 18.11.2019.

Rezulton se nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku nuk është kryer asnjë veprim hetimor i urdhëruar nga prokurori

Më pas procedimi penal i është ngarkuar për ndjekje prokurorit Xhelian Seferi, i cili në datën 03.12.2021, nëpërmjet email – it zyrtar i ka kërkuar oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku të informacion për ecurinë e procedimit penal dhe dorëzimin e dosjes në prokurori. Nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku nuk i është kthyer përgjigje prokuroit Xhelian Seferi.

Po me Email – in zyrtar, datë 16.12.2021 nga prokurori Xhelian Seferi, i është kërkuar përsëri oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku të përcillte në prokurori aktet e procedimit penal Përsëri nga oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku nuk ka patur asnjë reagim. Përfundimisht fashikulli i procedimit penal është dorëzuar në prokurori në datën 17.12.2021.

Sikurse rezulton nga aktet e dosjes, nuk është kryer asnjë veprim hetimor i urdheruar nga prokurori dhe dosja është mbajtur në dorë pa veprime nga oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku tej çdo afati ligjor dhe të arsyeshëm. Kthimi i fashikullit të procedimit penal në prokurori është bërë pas kërkesave të përsëritura të prokurorit të çështjes. Nga aktet që ndodhen në fashikullin e procedimit penal, rezulton fashikulli i hetimit është mbajtur në mënyrë të pajustificuar për një kohë shumë të gjatë,

Gjithashtu, nga provat e administruara rezultoi se , procedimet penale të analizuara më lart, kanë të bëjnë me ngjarje të cilat janë referuar prej oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku. Veprimet hetimore që janë urdheruar për tu kryer kanë qenë veprime jo të natyrës së vështirë dhe kryerja e tyre nuk kërkonte shumë kohë.

Moskryerja e veprimeve hetimore brenda afateve të caktuara nga prokurori dhe mbajtja e dosjeve pa veprime hetimore tej çdo afati të arsyeshëm, ka sjellë si pasojë zvaritje të pajustificuara dhe të perseritura të hetimeve dhe ka cenuar të drejtën e qytetareve për të patur akses në drejtesi në një kohë sa me të shpejtë.

3.Komisioni i Policisë Gjyqësore konstatoi se në të dy procedimet penale të mara në shqyrtim, sikurse rezulton nga aktet e dosjes penale, nuk janë kryer veprimet hetimore të urdheruara nga prokurori. Edhe ato pak veprime hetimore të pasqyruara në aktet e dosjes, janë kryer tej afatit të caktuar në urdherat e delegimit të prokurorit dhe tej çdo të arsyeshëm.

Komisioni konstaton se nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku, gjatë hetimit të procedimeve penale **nr.2107/2019**, dhe **nr.2084/2019**, janë kryer shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale sikurse janë:

- Shkelja e normave dhe kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale cilat rregullojnë mënyrën dhe afatet e ushtrimit të ndjekjes penale, afatet e hetimeve paraprake. Madje, oficeri i policisë gjyqësore Olsi Marku nuk i është përgjigjur as kërkesave për informacion të prokurorit të çështjes. Edhe kur prokurori ka kërkuar informacion dhe aktet e procedimeve penale, oficeri i policisë gjyqësore Olsi Marku nuk ka reaguar, por ka vazhduar të mbajë dosjen tej këtyre afateve. Mbajtja e procedimeve penale, tej afateve ligjore ka çuar në kalimin e çdo afati të arsyeshëm dhe ligjor, të caktuar për hetimin e procedimeve penale.

- Me mosdërgimin e fashikujve të hetimit të prokurori , brenda afatit të caktuar nga prokurori dhe brenda afateve të parashikuara nga K.Pr.Penale, megjithë kërkesat e vazhdueshme të tij si dhe mos informimin e prokurorit në vijimësi për ecurinë e hetimeve, ka cenuar kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale që rregullojnë mardhëiet midis oficerit të policisë gjyqësore dhe prokurorit.

- Gjithashtu, Komisioni konstaton se nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku me neglizhencën e theksuar të tij, shkeljen haptazi dhe në mënyrë të përsëritur të urdhërave të ligjshëm të prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore brenda një afati të caktuar, moszbatimin haptazi të kërkesave verbale apo me shkrim për kthimin urgjent të fashikujve të

procedimeve penale, të cilave ju ka kaluar afati, duke passjellë zvarritje të afateve hetimore përtej çdo lloj afati normal dhe të arsyeshëm, janë shkelur dukshëm dhe në mënyrë të përsëritur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale dhe nenet 5/1, gërma d, 7/1, 2, të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Në nenin 7, të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, përcaktohet se “Oficeri i policisë gjyqësore, ushtron funksionet e tij për hetimin e çështjes konkrete nën varësinë e prokurorit dhe drejtohet e kontrollohet prej tij. Ai zbaton urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve” Ndërsa neni 5, pika 1, shkronja “d”, e këtij ligji, parashikon se “ oficeri i Policisë Gjyqësore kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar nga prokurori”,

4. Në çmim të Komisionit, shkeljet e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale lidhur me afatin e hetimeve dhe moskryerjen brenda afateve të parashikuara në ligj dhe urdhërin e delegimit të prokurorit, të veprimeve hetimore si dhe mosinformimi në vijimësi i prokurorit për ecurinë e hetimeve, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Olsi Marku, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që sjellin, përbëjnë shkelje disiplinore, të parashikuar nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”

- Komisioni vlerëson se shkelja e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale për afatet e hetimit, mbajtja në dorë e procedimeve penale, pa kryer veprime hetimore tej çdo afati të arsyeshëm, dhe pasojat që ka sjellë kryerja e veprimeve hetimore tej këtij afati, përbëjnë shkelje disiplinore në formën e **“zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj”**, parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “a” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Neglizhenca e theksuar e tij, shkelja haptazi dhe në mënyrë të përsëritur e urdhërave të ligjshëm të prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore brenda një afati të caktuar, moskryerja e tyre edhe pas ndërhyrjeve të prokurorit, dhe mos evidentimi i asnjë shkak apo arsye për zgjatjen e hetimeve, i bënë zvarritjet në hetimin e procedimeve penale të pajustificuara. Ndërsa zvarritjet e lejuara në dy procedime penale, bënë që ato të konsiderohen të përsëritura, në kuptim të shkronjës “a” të pikës 3 të nenit 33 të ligjit të sipërcituar.

- Veç sa sipër, veprimet dhe mosveprimet e oficerit të Policisë Gjyqësore Olsi Marku, duke mosinformuar prokurorin e çështjes për ecurinë e hetimeve për dy vjet, duke mos ju përgjigjur prokurorit për kryerjen në afat të veprimeve hetimore të deleguara prej tij si dhe mosdërgimi i fashikujve të hetimit te prokurori megjithë kërkesat e vazhdueshme të tij, përbëjnë shkelje disiplinore në formën **“mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht”**, parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “ç” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

5. Në përfundim, në analizë dhe vlerësim të akteve të administruar gjatë shqyrtimit të proçesit disiplinor, përfshirë dhe sqarimet dhe shpjegimet e subjektit të procedimit disiplinor, Komisioni i Policisë Gjyqësore, arrin në përfundimin se, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku, me veprimet dhe mosveprimet e tij, gjatë hetimit të procedimeve penale **nr.2084/2019** dhe **nr.2107/2019**, janë kryer shkeljet disiplinore në formën:

- *“zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj”,* parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “a” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

- *“mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht”,* parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “ç” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Olsi Marku, shpjegon se, vonesat kane ardhur për shkak të ngarkesës në punë. Sipas shpjegimeve të tij, në veprimtarinë e përditshme, ka kryer dhe detyra të tjera, pjesë e funksioneve të Policisë, së Shtetit.

Shpjegoimet dhe pretendimet e oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku, nuk justifikojnë shkeljet e kryera dhe vonesat në hetimin e procedimit penal. Ngarkesa në punë që oficeri i policisë gjyqësore ka përballuar gjatë përfshirjes së tij në aktivitete të tjera të punës policore, nuk mund të justifikojnë zvarritjet dhe mosplotësimin e detyrimeve ligjore gjatë hetimit të procedimeve penale. Referuar, ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenet 2, pika 6 dhe neni 4, gërma “b”, oficerët e policisë gjyqësore të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, të ngarkuar posaçërisht me kryerjen e hetimeve, kanë detyrimin ligjor për marrjen e masave për respektimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit që rregullojnë dhe dispijlojnë oficerët e policisë gjyqësore për hetimin e veprave penale.

6.. Duke i konsideruar të provuara shkeljet disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Olsi Marku, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33, i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në pikën 3 të këtij neni, në gërmat “a” dhe “ç”, parashikon si **shkelje të rënda**, *“zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj”,* dhe *“mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht”*

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Olsi Marku, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljeve disiplinore të kryera prej tij, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit lidhur me ngarkesën në punë dhe personalitetin e tij. Komisioni merr parasysh faktin që, gjatë vitit 2020 ka përballuar një volum të konsiderueshëm pune .

Gjithashtu Komisioni i referohet parashikimeve të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer. Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas radhës, **a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje ma**

paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në në vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.

Në pikën 3 të nenit 34, parashikohet se, për shkeljet e rënda, jepet masa disiplinore “ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në në vit”

Gjitashtu, Komisioni konstaton se në rastin objekt shqyrtimi, janë konsumuar dy shkelje disiplinore nga oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku, të cilat, ligji 25/2019 i klasifikon shkelje të rënda. Në raste të tilla, kur ka konkurim të shkeljeve disiplinore dhe shkeljeve të konstatuara u përkojnë të njëjtat masa disiplinore, bazuar në nenin 1, pikat 5 dhe 6 të Rregullores nr.1, datë 21.04.2020 “Për procedimin disiplinor”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, Komisioni duhet të japë një masë të vetme disiplinore.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku të japë masën disiplinore “**ulje në detyrë me afat tre muaj**”, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “c” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”,11, pika 4; nenit 33, pika 2, gërma “a”, pika 3, gërmat “a” dhe “ç”, neni 34, pika 1, gërma “c”, pika 3 dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore, me 5 vota pro,

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore **Olsi Marku**, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, i jepet masa disiplinore “**Ulje në detyrë me afat tre muaj**”. *Gjatë kësaj periudhe oficerit të Policisë së Shtetit Olsi Marku i ndalohet të ushtrojë funksionet e oficerit të policisë gjyqësore.*
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Olsi Marku, i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Olsi Marku.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇA



ANËTAR

HARI GOGO



ANËTAR

REDI VASILI



ANËTAR

ALBERT MUÇO

